

Traktati Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratës së Pasurive

Preambula

Palët në këtë Traktat,

Të shqetësuar për problemet dhe rreziqet që dalin nga korrupsioni për stabilitetin e institucioneve demokratike, vlerat e demokracisë, për drejtësinë, paanshmërinë dhe qeverisjen e mirë, si dhe për funksionimin e duhur dhe të drejtë të ekonomive,

Të vendosur për të forcuar integritetin e sektorit publik në një mënyrë më efektive dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar duke bërë publike interesat financiare dhe private,

Duke dëshiruar një shkëmbim informacioni rreth financave dhe interesave personale për këtë qëllim,

Duke rikujtuar detyrimet e Palëve që rrjedhin nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 31 tetor 2003¹, dhe në veçanti pika 1 e Nenit 43, sipas të cilit Palët shqyrtojnë të ndihmojnë njëri-tjetrin në hetimet dhe gjykimet e çështjet civile dhe administrative që kanë të bëjnë me korrupsionin,

Duke rikujtuar gjithashtu Rezolutën 6/4 të Konferencës së Gjashtë të Shteteve Palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit të 6 nëntorit 2015², duke u bërë thirrje Palëve në Konventë që t'i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë sa më të gjerë të mundshme në hetimet dhe gjykimet për çështjet civile dhe administrative lidhur me veprat e korrupsionit dhe duke inkurajuar Palët në Konventë që të shqyrtojnë mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve ose traktateve shumëpalëshe, rajonale ose dypalëshe për çështjet civile dhe administrative në lidhje me korrupsionin, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar;

Duke pasur parasysh Konventën për Ndihmë të Ndërsjelltë Administrative në Çështjet Tatimore të 25 janarit 1988³, Protokollin e 27 majit 2010⁴ që ndryshon Konventën në fjalë, Marrëveshjen Model të vitit 2002 për Shkëmbimin e Informacionit mbi Çështjet Tatimore të zhvilluar nga Grupi i Punës i Forumit Global të OECD-së për Shkëmbimin Efektiv të Informacionit⁵ dhe Parimet e Nivelit të Lartë të vitit 2012 mbi Deklarimin e Pasurisë nga Zyrtarët Publikë të miratuar nga Grupi i Njëzet Vendeve (G20),⁶

¹Shtojca e Rezolutës A/58/4.

²CAC/COSP 6 Resolution 6/4.

³European Treaty Series (ETS) Nr. 127.

⁴European Treaty Series (ETS) Nr. 208.

⁵Shih website e OECD-së

⁶Shih [website](#) e Ministrisë së Drejtësisë në Gjermani

Duke u bërë pjesë organizatave ndërkombëtare dhe rajonale për të mbështetur dhe promovuar qëllimin e këtij Traktati në përputhje me Nenin 1,

Duke pranuar punën e bërë nga Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI),

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Kreu I Dispozita të përgjithshme

Neni 1. Qëllimi dhe fusha e zbatimit e Traktatit

1. *[Qëllimi]* Qëllimi i këtij Traktati është parandalimi i korrupsionit duke siguruar një shkëmbim të drejtpërdrejtë administrativ të informacionit të deklaratave të pasurive ndërmjet Palëve në Traktat.

2. *[Fusha e përgjithshme e zbatimit]* Traktati zbatohet për shkëmbimin e informacionit pavarësisht nëse sistemi i deklarimit të Palës së cilës i drejtohet kërkesa përfshin në veçanti aspekte identike të financave ose interesave personale, mbulon të njëjtat kategori të deklaruesve, përdor të njëjtat procedura për verifikimin e vërtetësisë së një deklaratë ose parashikon të njëjtat pasoja sikurse sistemi i deklarimit të Palës kërkuese.

3. *[Fusha e zgjeruar e zbatimit]* Traktati zbatohet gjithashtu për shkëmbimin e informacionit në rastet kur Pala së cilës i kërkohet të japë informacion nuk kërkon që çdo deklarues nën juridiksionin e saj të paraqesë një deklaratë pasurie.

Neni 2. Përkufizime

Për qëllime të këtij Traktati, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

(a) “deklaratë pasurie” është një deklaratë e bërë autoriteteve përkatëse ku deklarohen interesat financave ose personale, siç parashikohet në pikën 5 të Nenit 8 (konflikti i interesave dhe papajtueshmëritë) dhe në pikën 5 të Nenit 52, (deklarimi i informacionit financiar) i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe siç përcaktohet nga legjislacioni i secilës Palë;

(b) “deklarues” janë personat, interesat financiare ose private të të cilëve deklarohen me anë të deklaratës së pasurisë, siç përcaktohet nga sistemi i deklarimit të Palës që bën kërkesën, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, zyrtarin publik dhe anëtarët e familjes së tij ose saj;

(c) “verifikimi” është procesi i verifikimit të vërtetësisë së një deklaratë të pasurisë duke i krahasuar të dhënat e saj me informacionin në bazat e të dhënave të shtetit dhe burime të tjera dhe duke zbuluar kështu pasurinë e fshehur ose konflikte interesi ose papajtueshmëri të padeklaruara;

(d) “verifikimi i shënjestruar” është verifikimi i një deklarate individuale, në veçanti, pas një ankese, një parregullsie ose një treguesi të ngjashëm specifik;

(e) “verifikimi i rastësishëm” është verifikimi i një kampioni të deklaratave bazuar në kriteret e përcaktuara me ligj të njëres prej Palëve në këtë Traktat;

(f) “Pika Kontakti” është një autoritet i një Pale, të caktuar sipas Nenit 9 të këtij Traktati, i cili është kompetent për shkëmbimin e informacionit me një autoritet të ngjashëm të një Pale tjetër.

Kreu II **Shkëmbimi i informacionit**

Neni 3. Informacioni i shkëmbyer

1. *[Kategoritë]* Informacioni që Pikat e Kontaktit mund të shkëmbejnë, në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni, i cili përfshin, por nuk kufizohet vetëm në informacionet e marra nga bazat e të dhënave të mbajtura nga autoritetet publike ose subjektet private për tatimet, llogaritë bankare, letrat me vlerë, bizneset, kompanitë, trustet dhe fondacionet, si dhe nga ente ligjore të ngjashme, për pasuritë e paluajtshme, automjetet dhe pasuritë e tjera të luajtshme, si dhe për të drejtat e pronësisë intelektuale.

2. *[Të dyja palët]* Pikat e Kontaktit shkëmbejnë informacionin që është në dispozicion sipas legjislacionit të brendshëm të të dyja Palëve për verifikimin e deklaratave të pasurive.

3. *[Njëra palë]* Pavarësisht nga pika 2 e këtij neni, një Pikë Kontakti mund t'i ofrojë në mënyrë vullnetare një Pike tjetër Kontakti informacione që mund të vihen në dispozicion vetëm sipas legjislacionit të brendshëm të kësaj Pike Kontakti për të bërë verifikimin e deklaratave të pasurisë.

Neni 4. Shkëmbimi i informacionit me kërkesë

1. *[Verifikimi i shënjestruar]* Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa siguron informacione sipas kërkesës për të bërë verifikim të shënjestruar.

2. *[Kërkesa]* Pika e Kontaktit kërkuese duhet t'i japë hollësitë e mëposhtme Palës së cilës i drejtohet kërkesa, për të treguar lidhjen e parashikueshme të informacionit me kërkesën:

(a) identitetin dhe pozicionin e deklaruesit, deklarata e pasurisë së të cilit është në proces verifikimi (përfshirë numrat personal të identifikimit apo elemente identifikues unikë të ngjashëm);

(b) një deklaratë të informacionit të kërkuar duke përfshirë natyrën e tij dhe formën në të cilën Pika e Kontaktit kërkuese dëshiron të marrë informacionin nga Pika e Kontaktit që i drejtohet kërkesa;

(c) një deklaratë që kërkesa është në përputhje me ligjin dhe praktikën administrative të Palës që ka krijuar Pikën e Kontaktit kërkuese, që nëse informacioni i kërkuar është nën juridiksionin e Pikës së Kontaktit kërkuese atëherë autoriteti që kryen verifikimin do të jetë në gjendje të marrë informacionin në bazë të ligjeve të Pikës së Kontaktit kërkuese ose sipas procedurës normale të praktikës administrative dhe që është në përputhje me këtë Traktat;

(d) një deklaratë që Pika e Kontaktit kërkuese ka shteruar të gjitha mjetet në dispozicion sipas ligjit të saj për të marrë informacionin, përveç atyre që do të shkaktonin vështirësi disproporcionale.

3. *[Formati]* Palët bien dakord mbi një format për kërkesat, i cili duhet të përdoret nga Palët kërkuese. Pikat e Kontaktit mund të bien dakord në çdo kohë në mënyrë dypalëshe ose shumëpalëshe për të ndryshuar formatin, i cili është i bashkangjitur si shtojcë e këtij Traktati.

4. *[Marrja e informacionit]* Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa përdor të gjitha mjetet e përshtatshme për grumbullimin e informacionit për t'i siguruar informacionin e kërkuar Pikës së Kontaktit kërkuese.

5. *[Shpejtësia]* Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa i përcjell Pikës së Kontaktit kërkuese informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur. Për të siguruar një përgjigje të menjëhershme, Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa konfirmon marrjen e kërkesës nga Pika e Kontaktit kërkuese dhe njofton Pikën e Kontaktit kërkuese për mangësitë që mund të ketë kërkesa.

6. *[Reagimi]* Nëse Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa nuk ka qenë në gjendje të sigurojë dhe japë informacionin brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, duke përfshirë pengesat që mund të ketë hasur në dhënien e informacionit, ajo informon menjëherë Pikën e Kontaktit kërkuese, duke shpjeguar arsyen që ka shkatuar pamundësinë e saj për të dhënë informacion ose natyrën e pengesave dhe deri kur pritet të japë informacionin.

7. *[Regjistri qendror]* Sekretariati i RAI lehtëson që të krijohet dhe përditësohet rregullisht një regjistër qendror i regjistrave publikë të disponueshëm nga secila Palë.

8. *[Verifikimet e rastësishme]* Pikat e Kontaktit të dy ose më shumë Palëve mund të bien dakord rast pas rasti për të shkëmbyer informacion me qëllim të verifikimeve të rastësishme.

Neni 5. Shkëmbimi automatik i informacionit

Palët mund të krijojnë mekanizma të shkëmbimit automatik të të dhënave. Për këtë qëllim, Pikat e Kontaktit mund të rregullojnë veçmas çështjet e procedurës dhe detajet teknike, përfshirë sigurinë e informacionit.

Neni 6. E drejta për refuzimin e kërkesës

1. *[Aryet]* Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa mund të refuzojë mbledhjen ose dhënien e informacionit
 - a. *[Ligjshmëria e brendshme]*, të cilin Pika e Kontaktit kërkuese nuk do të ishte në gjendje të merrte në bazë të ligjeve të veta për qëllime të verifikimit të deklaratave të veta të pasurisë;
 - b. *[Ligjshmëria]* nëse kërkesa nuk është bërë në përputhje me këtë Traktat;
 - c. *[Rendi publik]* nëse Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa e konsideron bërjen publike të informacionit në kundërshtim me *rendin publik* ose me interesa të tjera thelbësore të Palës që e ka krijuar këtë informacion;
 - d. *[Sasia]* nëse Pika e Kontaktit së cilës i drejtohet kërkesa konsideron se shumica e përgjithshme e kërkesave të marra prej tij nga Pikat e Kontaktit gjatë 12 muajve të fundit e tejkalon numrin që mund të administrojë në mënyrë të arsyeshme;
 - e. *[Pamundësia]* nëse është *de facto* e pamundur për Pikën e Kontaktit së cilës i është drejtuar kërkesa të marrë të dhënat (Neni 4, pika 6).
2. *[Përgjigja]* Nëse një Pikë Kontakti vendos të refuzojë një kërkesë në përputhje me pikën 1 të këtij Neni, ajo informon menjëherë Pikën e Kontaktit kërkuese, duke shpjeguar arsyet për vendimin e saj.

Neni 7. Të dhënat e hapura dhe aksesit i drejtpërdrejtë

1. *[Bazat e të dhënave në internet]* Autoritetet e një Pale mund të bëjnë kërkime dhe të përdorin informacionin që është në dispozicion në internet për këdo në regjistrat publike ose private të disponueshëm në territorin e një Pale tjetër, nëse autoritetet e përdorin këtë lloj informacioni për verifikimin e deklaratave të pasurisë sipas ligjit të tyre të brendshëm. Neni 9 nuk zbatohet për të dhënat e marra me këto mjete.
2. *[Regjistri qendror; gjuba]* Sekretariati i RAI lehtëson krijimin dhe përditësimin e rregullt nga Palët të një regjistri qendror të bazave të të dhënave pa pagesë në internet. Nëse këto baza të të dhënave nuk sigurojnë një ndërfaqe në gjuhën angleze, Palët mund t'i ofrojnë mbështetje njëra-tjetrës nëpërmjet masave të tilla si ndërfaqet e përkthyer.
3. *[Bazat e të dhënave me akses të kufizuar]* Nëse informacioni në regjistrat shtetëror është në dispozicion në internet për çdo qytetar të një Pale, me disa kufizime të caktuara (të tilla si kërkesat për regjistrim, tarifa për të pasur akses ose kufizime në përdorim), kjo Palë mund t'u sigurojë Palëve të tjera akses të drejtpërdrejtë në këto baza të të dhënave. Palët do të shqyrtojnë mundësinë e lidhjeve të marrëveshjeve dypalëshe, të tilla si marrëveshje bashkëpunimi, për të rregulluar detaje të mëtejshme.

4. *[Aksesi në deklarata]* Me qëllim që të lehtësohet përdorimi nga të huajt i deklaratave të pasurive, secila Palë merr në konsideratë shtimin e përpjekjeve për të ofruar falas në internet të dhëna nga deklaratat që disponon, në atë masë që publiku ka të drejtë të ketë informacion mbi to. Secila Palë konsideron gjithashtu shtimin e përpjekjeve për të krijuar bazat e të dhënave në internet duke i lejuar përdoruesit të kenë akses në deklaratate pasurisë nëpërmjet një ndërfaqe në gjuhën angleze, përveç gjuhës ose gjuhëve zyrtare të Palës.

Neni 8. Shkëmbimi spontan i informacionit

Një Pikë Kontakti mundet që pa kërkesë paraprake t'i transmetojë një Pike tjetër Kontakti informacion që ka ardhur në vëmendjen e Pikës së parë të Kontaktit dhe që Pika e Kontaktit e përmendur në fillim e konsideron si parashikueshmërisht të përshtatshëm për përmbushjen e qëllimit të Traktatit të parashikuar në Nenin 1. Pikat e Kontaktit mund të përcaktojnë rast pas rasti procedurat që do të përdoren për shkëmbimin e një informacioni të tillë.

Neni 9. Konfidencialiteti

1. *[Mbrojtja e të dhënave]* Çdo informacion i marrë nga një Pikë Kontakti do të trajtohet si konfidencial dhe i mbrojtur në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë sipas legjislacionit të brendshëm të Palës përkatëse dhe, në masën e nevojshme për të siguruar nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me masat mbrojtëse të cilat mund të specifikohen nga Pika e Kontaktit që jep informacionin, siç kërkohet sipas legjislacionit të saj të brendshëm.

2. *[Rrethi i ndarjes së informacionit]* Informacioni i mësipërm, në çdo rast, ndahet vetëm me personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative ose mbikëqyrëse) që kanë të bëjnë me verifikimin, zbatimin ose ndjekjen penale në lidhje me, ose përcaktimin e apelimeve në lidhje me, vërtetësinë e deklaratave të pasurisë të asaj Pale, ose mbikëqyrjen e sa më sipër. Vetëm personat ose autoritetet e përmendura më sipër mund të përdorin informacionin dhe vetëm për qëllimet e sipërpërmendura. Pavarësisht nga dispozitat e pikës 1, ata mund ta bëjnë publik informacionin në procedurat gjyqësore publike civile ose administrative ose në vendimet gjyqësore të gjykatave civile ose administrative për deklaratat e pasurisë.

3. *[Të dhënat e hapura]* Paragrafët 1 dhe 2 nuk zbatohen për informacionin e marrë në përputhje me Nenin 7.

Neni 10. Pikat e Kontaktit

1. *[Caktimi]* Për shkëmbimin e informacionit të parashikuar në Kreun II, secila Palë cakton një Pikë Kontakti, siç përcaktohet në Nenin 2, lit. f. Në veçanti, Pika e Kontaktit bën dhe merr kërkesa për informacion dhe ose do të japë informacionin e kërkuar, ose do ta mbledhë atë nga autoritetet kompetente vendase.

2. *[Rajonet]* Nëse një Palë ka një rajon apo territor të veçantë i cili ka një sistem të veçantë të verifikimit të deklaratave të pasurisë, ajo mund të caktojë një Pikë Kontakti të veçantë që ka të njëjtin funksion siç përshkruhet në pikën 1 për atë rajon ose territor.

3. *[Statistikat]* Pikat e Kontaktit publikojnë statistika vjetore për kërkesat e bëra dhe të marra prej tyre në gjuhën e tyre zyrtare dhe përveç kësaj, në masën e mundshme, edhe në gjuhën angleze.

4. *[Kompetencat e brendshme]* Pas ratifikimit, pranimit ose miratimit të këtij Traktati nga njëra Palë, kompetencat ligjore të Pikës së Kontaktit të saj dhe të autoriteteve të tjera me të cilat ajo bashkëpunon për marrjen e informacionit për verifikimin e deklaratave të pasurive të deklaruesve vendas do të shtrihen për informacionin e shkëmbyer në bazë të këtij Traktati.

Neni 11. Shpenzimet

Ndihma e dhënë në bazë të këtij Traktati nuk ka shpenzime. Kostot e shkaktuara rastësisht në dhënien e ndihmës në raste të veçanta rregullohen me marrëveshje nga Pikat e Kontaktit të vendeve respektive para shkëmbimit të të dhënave. Për shpenzimet do të zbatohet legjislacioni kombëtar i Palës së Pikës së Kontaktit të cilës i është drejtuar kërkesa.

Neni 12. Gjuha

Kërkesat për ndihmë dhe përgjigjet e tyre duhet të hartohen në gjuhën angleze ose në ndonjë gjuhë tjetër të rënë dakord në mënyrë dypalëshe midis Pikave të Kontaktit të vendeve përkatëse ose në gjuhën e Pikës së Kontaktit të cilës i drejtohet kërkesa.

Kreu III Dispozita përfundimtare

Neni 13. Marrëveshje dhe rregullore të tjera ndërkombëtare; Legjislacioni i Bashkimit European

1. Ky Traktat nuk kufizon shkëmbimin e informacionit të parashikuar në marrëveshjet e tjera ndërkombëtare ose rregulloret e tjera që janë në fuqi për Palët.

2. Asgjë në këtë Traktat nuk duhet të interpretohet si kufizuese ose që ndikon negativisht në detyrimet e Palëve të këtij Traktati që rrjedhin nga anëtarësimi i tyre në Bashkimin European.

Neni 14. Firmosja, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Traktat është i hapur për t'u firmosur nga të gjitha shtetet prej ____ deri _____ në _____, dhe më pas në _____ në _____ deri në _____.

2. Ky Traktat i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës së Serbisë.

3. Ky Traktat është i hapur për aderim për çdo shtet ose çdo territor i cili në mënyrë autonome është në gjendje të përmbushë qëllimin e Traktatit të parashikuar në Nenin 1. Instrumentet e anëtarësimit depozitohen në Qeverinë e Republikës së Serbisë.

4. Bashkimi European mund të bëhet anëtar i këtij Traktati.

Neni 15. Hyrja në fuqi dhe zbatim i përkohshëm

1. Ky Traktat hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së depozitimit të të paktën tre instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

2. Për çdo shtet ose territor që ratifikon, pranon, miraton ose anëtarësohet në këtë Traktat pas hyrjes në fuqi të tij në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Traktati hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit përkatës. I njëjti rregull zbatohet edhe në rast të anëtarësimit të Bashkimit European në këtë Traktat.

3. Deri në hyrjen në fuqi të këtij Traktati, ky Traktat mund të zbatohet përkohësisht nga Shtetet që e kanë firmosur atë në përputhje me pikën 1 të Nenit 14 dhe pas një deklaratë të bërë nga Shteti pas firmosjes.

4. Në pritje të hyrjes në fuqi të këtij Traktati për një shtet ose territor që anëtarësohet në të, në përputhje me pikën 3 të Nenit 14, ky Traktat zbatohet përkohësisht ndërmjet atij shteti ose territori dhe Palëve në Traktat.

5. Ky Traktat zbatohet për çdo verifikim në vazhdim të një deklaratë pasurie ose për çdo procedure verifikimi të filluar ose të rihapur nga një Palë kërkuese pas hyrjes në fuqi të Traktatit për atë Palë, edhe nëse deklarata është dorëzuar përpara asaj date.

6. Ky Traktat zbatohet pavarësisht nga ndryshimet që mund të ndodhin në sistemin e deklarimit të pasurisë të një Pale pas hyrjes në fuqi të Traktatit.

Neni 16. Amendimi

1. Pas përfundimit të tre viteve nga hyrja në fuqi e këtij Traktati, një Palë mund të propozojë një ndryshim dhe t'ia transmetojë atë Shtetit Depozitar i cili më pas do t'ua komunikojë ndryshimin e propozuar Palëve për shqyrtimin e propozimit. Nëse të paktën tre Palë dëshirojnë ta bëjnë këtë, depozitari thërret një mbledhje të Palëve për të diskutuar dhe për të marrë vendim mbi propozimin. Mbledhja bën të gjitha përpjekjet për të arritur konsensusin për çdo amendim. Nëse janë shteruar të gjitha përpjekjet, për miratimin e një ndryshimi nevojitet një shumicë prej dy të tretave të Palëve të pranishme dhe që votojnë.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga Palët.

3. Një amendament hyn në fuqi për një Palë tridhjetë ditë pas datës së depozitimit pranë depozitarit të një instrumenti të ratifikimit, pranimit ose miratimit të këtij amendamenti nga ajo Palë.

4. Një Palë e cila nuk ratifikon, pranon ose miraton një amendament vazhdon të zbatohet dispozitat e këtij Traktati dhe çdo amendament të mëparshëm që ka ratifikuar, pranuar ose miratuar.

Neni 17. Prishja e marrëveshjes

1. Një Palë mund të largohet nga ky Traktat me anë të një njoftimi me shkrim tek depozitari. Një prishje e tillë e marrëveshjes hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari.

2. Çdo Palë që largohet nga ky Traktat ka detyrimin të zbatohet dispozitat e Nenit 9 (Konfidencialiteti).

Neni 18. Detyrat e Shtetit Depozitar

1. Origjinali i këtij Traktati, i cili është hartuar në gjuhën angleze, depozitohet në Qeverinë e Republikës së Serbisë, e cila u dërgon të gjitha Palëve kopje të noterizuara të Traktatit.

2. Qeveria e Republikës së Serbisë është caktuar të jetë vendi depozitar i këtij Traktati.

3. Depozitari njofton të gjitha Palët për:

(a) depozitimin e çdo instrumenti për ratifikimin, pranimin, miratimin ose anëtarësimin në këtë Traktat;

(b) çdo amendament të miratuar në përputhje me Nenin 16;

(c) datën në të cilën Traktati hyn në fuqi për një Shtet ose një territor që ka shprehur pëlqimin e tij për t'u bërë Palë në Traktat ose për Bashkimin Europian;

(d) çdo njoftim me anë të të cilit një Palë largohet nga ky Traktat në përputhje me Nenin 17;

(e) çdo akt apo njoftim tjetër i një Pale në lidhje me këtë Traktat.

4. Me kërkesë të një Pale, depozitari mund të thërrasë një mbledhje të Palëve për të diskutuar çështjet që lidhen me interpretimin ose zbatimin e Traktatit.

Shtojca në përputhje me pikën 3 të Nenit 4 të Traktatit: Formulari i Kërkesës

1.	Pika e Kontaktit që bën kërkesën:	
2.	Detajet e kontaktit (email, numër telefoni):	
3.	Emri/pozicioni i personit:	
4.	Emri i deklaruësit:	
5.	Emër tjetër, transliterim (et):	
6.	Data e lindjes (DD/MM/VVVV):	
7.	Kombësia	
8.	Gjinia	Mashkull <input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/>
9.	Mjeti personal i identifikimit (lloji dhe numri):	
10.	Arsyeja e deklaramit (pozicioni zyrtar, anëtar i familjes së zyrtarit publik):	
11.	Lloji i verifikimit:	I shënjestruar <input type="checkbox"/> I rastësishëm <input type="checkbox"/>
12.	Çfarë informacioni kërkohet? (emri i kompanisë, targa e automjetit, etj):	
13.	Ju lutem dërgoni informacionin me:	Email <input type="checkbox"/> Faks <input type="checkbox"/> Letër <input type="checkbox"/>
14.	Komente shtesë:	

I nënshkruari konfirmon:

- se kërkesa është në përputhje me ligjin dhe praktikën administrative të Pikës së Kontaktit,
- se nëse informacioni i kërkuar është nën juridiksionin e Pikës së Kontaktit kërkuese atëherë autoriteti që kryen verifikimin do të jetë në gjendje të marrë informacionin në bazë të ligjeve të vendit të Pikës Kontaktit kërkuese ose në rrjedhën normale të praktikës administrative,
- se kërkesa është në përputhje me këtë Traktat,
- dhe se Pika e Kontaktit që bën kërkesën ka shteruar të gjitha mjetet në dispozicion sipas ligjit të saj për marrjen e informacionit, përveç atyre mjeteve që do të shkaktonin vështirësi disproporcionale.

Data

Firma